

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **210-26-3950-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Angazhimi i një OE për konfiskimin e masës drusore dhe paisjeve tjera përcjellëse në teritorin e DAPK Bjeshkëtn e Nemuna dhe DAPK Sharr**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	" XONI " SH.P.K.
NUI	810086711
Adresa	Brigada 123
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+38349521093
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Gjevat Kabashaj
Adresa elektronike	xoni.shpk84@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	28.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Angazhimi i një OE për konfiskimin e masës drusore dhe paisjeve tjera përcjellëse në teritorin e DAPK Bjeshkëtn e Nemuna Angazhimi i një OE për konfiskimin e masës drusore dhe paisjeve tjera përcjellëse në teritorin e DAPK SHARR

Me datë: 25.05.2026 është publikuar Njoftim për Kontratë për këtë procedurë.

Me datë: 16.06.2026 është bërë dorëzimi I ofertave dhe hapja e tyre.

Me datë: 14.07.2026 AK ka publikuar Njoftim Vendimin (B58) dhe Letrat Standarde

Me datë: 20.07.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK, pasi që kemi analizuar ofertat dhe dëshmitë e OE të rekomanduar dhe OE tjetër në këtë procedurë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datë: 20.07.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK, pasi që kemi analizuar ofertat dhe dëshmitë e OE të rekomanduar dhe OE tjetër në këtë procedurë.

AK me datë: 22.07.2026, na ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, duke e konfirmuar se njëri prej OE është I pa përgjegjshëm por për shkak se kishte çmimin më të lartë se OE I rekomanduar, nuk ndryshon “rezultati”.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 71 Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

PRETENDIMI NR. 1

Autoriteti Kontraktues (AK) ka rekomanduar për dhënie të kontratës një Operator

Ekonomik (OE), i cili nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit (FDT) lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional.

Kërkesat e FDT-së

Kërkesa 9.1.1 – Për Lotin 1 dhe Lotin 2

Kërkesa:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme për realizimin e së paku **një (1) kontrate për shërbime të ngjashme** gjatë tri (3) viteve të fundit para publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia e kërkuar:

Një listë që specifikon kontratat relevante, duke përfshirë:

- përshkrimin e shërbimeve;
- vlerën e kontratës;
- datën e realizimit;
- pranuesin;
- certifikatën e pranimi ose së paku një (1) referencë.

Kërkesa 9.1.2 – Për Lotin 1 dhe Lotin 2

Operatori Ekonomik duhet të ketë së paku katër (4) punëtorë që do të angazhohen për realizimin e shërbimeve.

Dëshmia e kërkuar:

Lista e punëtorëve, së bashku me para-kontratat e punës, që përmbajnë emrin, mbiemrin dhe pozitën në kompani, të nënshkruara dhe vulosura nga Operatori Ekonomik.

Arsyetimi

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Operatori Ekonomik i rekomanduar rezulton se ai **nuk ka dëshmuar realizimin e asnjë kontrate të ngjashme**, sipas kërkesës së FDT-së.

Megjithatë, AK ka konsideruar si kontratë të ngjashme kontratën me objekt:

"Rrënimi i objekteve pa leje dhe me rrezikshmëri në Komunën e Suharekës",

duke e krahasuar me objektin e kësaj procedure:

"Angazhimi i një Operatori Ekonomik për konfiskimin e masës drusore dhe pajisjeve tjera përcjellëse në territorin e DAPK Bjeshkët e Nemuna dhe DAPK Sharr".

Ky vlerësim është i gabuar dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik.

Sipas praktikës së prokurimit publik, një kontratë mund të konsiderohet e ngjashme vetëm

nëse ekziston ngjashmëri substanciale në:

- objektin e kontratës;
- natyrën e shërbimeve;
- teknologjinë dhe metodologjinë e realizimit;
- pajisjet dhe mekanizimin e përdorur;
- ekspertizën profesionale të kërkuar;
- organizimin e punës dhe rreziqet operative.

Në rastin konkret këto elemente mungojnë plotësisht.

Së pari, objekti i kontratës është krejtësisht i ndryshëm.

- Kontrata objekt e këtij tenderi ka të bëjë me konfiskimin, ngarkimin, transportin dhe ruajtjen e masës drusore dhe mjeteve të konfiskuara.
- Kontrata e paraqitur nga OE ka të bëjë me rrënimin (demolimin) e objekteve ndërtimore.

Së dyti, aktivitetet operative janë të ndryshme.

- Konfiskimi i masës drusore përfshin operacione pyjore, manipulim me produkte pyjore dhe transport të tyre.
- Demolimi përfshin shembjen e objekteve ndërtimore dhe menaxhimin e mbetjeve ndërtimore.

Së treti, pajisjet dhe mekanizimi janë krejtësisht të ndryshëm.

- Kontrata objekt e tenderit kërkon kamionë, traktorë me sajllë, motorë për prerjen e drurit dhe pajisje për transport të masës drusore.
- Kontrata për demolim realizohet me eskavatorë, makineri demolimi dhe pajisje ndërtimore.

Së katërti, ekspertiza profesionale e kërkuar nuk është e njëjtë.

- Procedura aktuale kërkon përvojë në operacione pyjore, logjistikë dhe transport.
- Kontrata e demolimit kërkon ekspertizë në fushën e ndërtimit dhe demolimit.

Së pesti, qëllimi dhe rezultati i kontratave janë të ndryshme.

- Njëra kontratë synon konfiskimin dhe transportimin e pasurisë së sekuestruar.
- Tjetra synon eliminimin fizik të objekteve ndërtimore.

Për rrjedhojë, kontrata e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk mund të konsiderohet kontratë e ngjashme në kuptim të kërkesës 9.1.1 të FDT-së.

Prandaj, Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe është dashur të eliminohet nga procedura, e jo të rekomandohet për dhënie të kontratës.(Dëshmia1):

LISTA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA PËR VITIN 2024 / 2025

NR	INVESTITORI	PROJEKTI	Nr Prokurimi	Nr Kontratës	Data e fillimit	Data e përfundimit	Shuma
14	Komuna Suharekë	Rrërimi i objekteve pa leje dhe me rrethshëmëri	624-23-12598-2-2-1	/C1105	09.01.2026	09-04-2026	21,480.00 €
VLERË TOTALE E PROJEKTEVE 2024/2025:							21,480.00 €

Suharekë me: 15-jun-2026



PRETENDIMI NR. 2

Po ashtu ka të bëjë me Operatorin Ekonomik të rekomanduar I cili nuk I ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale pra kërkesat në pikën 7.1 & 7.2 të dosjes së tenderit:

Kërkesa e FDT-së: 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit 2.Regjistrimi i TVSH; 3.Certifikata e numrit fiskal – kopje

Dëshmia e kërkuar me FDT: Certifikata e regjistrimit të biznesit – kopje Certifikata e TVSH – kopje Certifikata e numrit fiskal – kopje Nëse ne Certifikatën e Regjistrimit të biznesit është i shënuar edhe numri fiskal atëherë Certifikata e Regjistrimit të Biznesit shërben edhe si dëshmi e Certifikatës

Nga analiza e certifikatave të regjistrimit të biznesit dhe të informatave të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë rezulton se veprimtaritë e regjistruara të tij nuk përputhen me natyrën e shërbimeve që janë objekt i kësaj procedure të prokurimit. Konkretisht, si lideri i grupit të operatorëve ekonomikë, ashtu edhe anëtari i grupit kanë të regjistruara veprimtari të ndryshme ekonomike, mirëpo asnjëra prej tyre nuk lidhet me objektin e kontratës që është duke u prokuruar.

Ky fakt tregon se Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e ka të regjistruar veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve që janë objekt i kësaj procedure, duke mos përmbushur kështu kërkesën për përshtatshmëri profesionale të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Duhet theksuar se Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, e ka klasifikuar objektin e prokurimit si **shërbim**, duke e identifikuar me kodin e Klasifikimit të Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP/CPV) **93000000-8**, i cili përcakton qartë natyrën e

veprimtarisë që duhet të mbulohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Nga shqyrtimi i informatave zyrtare të biznesit për të dy anëtarët e grupit të operatorëve ekonomikë rezulton qartë se asnjëri prej tyre nuk e ka të regjistruar veprimtarinë përkatëse që mbulon shërbimet e kërkuara me Dosjen e Tenderit, qoftë si veprimtari primare, sekondare apo si veprimtari tjetër e regjistruar.

Për më tepër, praktika vendimmarrëse e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) ka trajtuar raste të ngjashme, në të cilat është konstatuar se mungesa e veprimtarisë përkatëse të regjistruar përbën mosplotësim të kërkesave të përshtatshmërisë profesionale, duke vendosur në favor të operatorëve ekonomikë që kanë ngritur pretendime të tilla.

PRETENDIMI NR. 3

Ky pretendim ka të bëjë me Operatorin Ekonomik **Mentor Hoxha B.I.**, të cilin Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës **14.07.2026**, e ka vlerësuar si operator që i plotëson kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke publikuar Letrën Standarde për Tenderuesin e Pasuksesshëm.

Me këtë veprim, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, pasi nuk ka bërë ekzaminim dhe vlerësim të drejtë të dokumentacionit të ofertës.

OE Mentor Hoxha B.I. nuk e ka përmbushur kërkesën 9.1.1 të FDT-së, e cila ka të bëjë me kontratat e ngjashme dhe referencat.

Konkretisht:

- Referenca e paraqitur i përket një kontrate që ka përfunduar më **23.04.2021**, ndërsa FDT kërkon kontrata të realizuara gjatë tri viteve para publikimit të njoftimit për kontratë. Për këtë arsye, kjo referencë është jashtë periudhës së kërkuar dhe nuk mund të merret në konsideratë. (Dëshmia2):



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË

Emri i projektit	Shërbimet e zhvendosjes me makinat dhe bllokimi të autopetave në territorin e Komunës së Malishevës
Lenda	REFERENCE E PJESËSHEME
Për	Grupi i OE "MENTOR HOXHA RI & NTSH "TUBO AG"
Sga	Drejtoria e Shërbimeve Publike
Data	10.02.2021

Grupi i OE "MENTOR HOXHA RI me seli në Malishevë me nr. të biznesit 811154632 & NTSH "TUBO AG" me seli në Prizren me nr. të biznesit 70803720 ka kryer shërbimet e zhvendosjes me makinat dhe bllokimi të autopetave në territorin e Komunës së Malishevës sipas specifikacionit të kontratës me nr. 8 e lidhur me datë 23/04/2019, me nr. të prokurimit 62500.19.011.220, kontratë kornizë për 24 muaj.

Shërbimet janë kryer në përputhje të plotë me kushtet e kontratës, gjithashtu grupi i OE është treguar shumë efikas duke qenë në gjendje gatishmërie gjatë gjithë kohës.

Cerimi total i kontratës, vlera për njësi për bllokimi precizose është 59.00€ , 30% nga kjo shuma janë për Komunën e Malishevës.

Atari i kontratës është dërguar me 23.04.2021, dhe kjo referencë vlenë për periudhën e dëshmimit.

Drejtori i Shërbimeve Publike
Mikazim Malina

Po ashtu, OE ka paraqitur dy kontrata të tjera.

Kontrata e parë është nënshkruar më **24.03.2026**, është ende në realizim dhe nuk shoqërohet me certifikatë pranimi apo referencë, siç kërkohet shprehimisht në FDT. (Dëshmia3):



Republika e Kosovës

Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr. 035

Data: 29/11/2023

29/11/2023

03/106

KONTRATË PROKURIMI NR.05

KONTRATA PUBLIKE KOMUNALE

625-26-573-2-2-1/C313

KOMUNAL MALISHEVE, (në varësi të "Autoritetit Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe Operatori Ekonomik: Mentor Hoxha B.I. (N.S.H. "TOU") me seli në Malishevë me Nr.Biznesi: 811154632 (në varësi të "Ofisës së Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijën:

SHËRBIMET E ZHVENDOSJES ME MARSHIMANGË DHE BLOKIMET TË AUTOMJETEVE NË TERRITORIN E KOMUNES SË MALISHEVËS me numër identifikues:

Arti i prokurimit	625-26-573-2-2-1
Nr i llozshimit	625-26-003-2-2-1

Nësi i Llozshimit

1.1 Llozshimi i kësaj kontrate publike kërkon që të themelohet kushti, duke përfshirë qëndruesit për njësi dhe reagimet e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijën: **Shërbimet e zhvendosjes me marshimangë dhe bllokime të automjeteve në territorin e Komunitetit të Malishevës**.

1.2 Komuniteti publik kërkon të implementohet me "zvendosjen e personave" nga shërbimi. P.sh. Kurto që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet (qësi Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, kurto të bëjë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kërkon, duhet që të dërgojë "personat" në Ofisën e Shërbimeve, duke specifikuar llojin e shërbimeve që duhet të performojnë me saktësi të tyre përkatëse.

1. Të raportohet në për dokument apo në bazë të të cilave me saktësi duhet të procedurohet.

Kontrata e dytë, e nënshkruar më 29.11.2023, përveç faktit se nuk ka objekt të ngjashëm me këtë procedurë të prokurimit, nuk është shoqëruar me asnjë referencë ose certifikatë pranimit.

Për rrjedhojë, OE Mentor Hoxha B.I. nuk ka përmbushur kërkesën 9.1.1 të FDT-së dhe është dashur të shpallet i papërgjegjshëm, e jo të kualifikohet për fazën e mëtejshme të procedurës.(Dëshmia4):

KONTRATË PROKURIMI Nr 57

(Kontratë Publike Komitë për 24 muaj)

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë, dhe
OE „MENTOR H. HOXHA B.I.“ me sasi në Prizren me Nr biznesi 811154032 (në
vazhdim "Operatori Ekonomik"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:
SHËRBIMET E ZHVENDOSIES ME MARRMANGË DHE BLDKIMET E AUTOMJETEVE NË
TERITORIN E KOMUNES SË MALISHEVËS me numër identifikues: 62500-29-12390-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike komitë do të themelohet kushtet, duke përfshirë
çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:
shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokime të automjeteve në territorin e
Komunes së Malishevës

1.2 Kontrata publike komitë do të implementohet me "vendosjen e porositve" apo thirrje.
P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në
këtë kontratë, shton të bllojë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike komitë, duhet që të
dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar llojin e shërbimeve që duhet
të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Listë e Çmimit, janë vetëm sasi
indikative. Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/ë detyruar të
përdorë/jnë këto marrimangë komitë sa herë që të pranojnë shërbimet e përmendura në
1.1.

1.4 Kontrata hyrë në fuqi me 29.11.2023 dhe përfundon në datën 27.11.2025.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerjen të shërbimeve do të jetë 24 muaj 24 orë në ditë, 7 ditë në javë
nga momenti i pranimit të kërkesës nga ana e policisë dhe inspektoratit të Komunitë.

2.2 Vendi i kryerjes të shërbimeve do të jetë territori i Komunitë së Malishevës.

PRETENDIMI NR. 4

Ky pretendim lidhet me mosplotësimin e kërkesës 9.1.3 të Dosjes së Tenderit nga OE
Mentor Hoxha B.I., e cila ka të bëjë me pajisjet teknike.

Kërkesa e FDT-së

Operatori Ekonomik duhet të disponojë ose të ketë marrë me qira:

- një (1) kamion ose traktor me sajlle për tërheqjen dhe ngarkim-shkarkimin e masës
drusore;
- një (1) kamion vetëshkarkues me kapacitet minimal prej 10 m³;
- një (1) motor dore për prerjen e drunjve;
- pajisje të tjera të nevojshme për realizimin e kontratës.

Dëshmia e kërkuar

Deklaratë e pajisjeve dhe mekanizimit në dispozicion të Operatorit Ekonomik ose kontratë
qiraje për këto mjete, e nënshkruar dhe vulosur nga palët.

Arsyetimi

OE Mentor Hoxha B.I.:

- nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për motorin e dorës për prerjen e drunjve, siç

kërkohet në pikën c) të kërkesës;

- nuk ka dorëzuar deklaratën e kërkuar nga FDT, por vetëm një listë të pajisjeve.

FDT kërkon në mënyrë të qartë **Deklaratë të pajisjeve teknike**, ndërsa lista e thjeshtë e mjeteve nuk përbën dëshmi ekuivalente dhe nuk e përmbush kërkesën e tenderit.

Për rrjedhojë, OE Mentor Hoxha B.I. nuk e ka plotësuar kërkesën 9.1.3 të Dosjes së Tenderit.(Dëshmia5):

NSH TOLI						
LISTA E MAKINERISË						
Nr.	Foto	Përshkrimi	Nr. i shtetit	Viti	Ngjyra	Peshë
1	KAMION					
1		MAN MM39	WMAM 39ZZZY Y06340 7	200	E KALTERT	Mbi 18 ton
2		MERCED ES BENZ	97026	2005	E Verdhe	Mbi 4 ton
3		MOTORR SHARR	STIHL			

PRETENDIMI NR. 5

Edhe ky pretendim lidhet me mosplotësimin e kërkesës 9.1.4 të Dosjes së Tenderit nga OE **Mentor Hoxha B.I.**

Kërkesa e FDT-së

Për Lotin 2, Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se posedon ose ka marrë me qira një depo me sipërfaqe minimale prej **1,700 m₂** për vendosjen dhe ruajtjen e mjeteve motorike të konfiskuara.

Dëshmia e kërkuar

- fletë poseduese; ose
- kontratë e qirasë për depon.

Arsyetimi

OE Mentor Hoxha B.I. nuk ka dorëzuar asnjë nga dëshmitë e kërkuara.

Në vend të dokumentacionit të kërkuar nga FDT, ai ka paraqitur vetëm tri fotografi të një hapësire, të cilat nuk provojnë:

- pronësinë mbi depon;
- ekzistimin e një kontrate qiraje;
- sipërfaqen minimale prej 1,700 m².

Fotografite nuk përbëjnë dëshmi juridike për plotësimin e kërkesës së FDT-së dhe nuk mund të zëvendësojnë dokumentet e kërkuara.

Për rrjedhojë, OE Mentor Hoxha B.I. nuk e ka përmbushur kërkesën 9.1.4 të Dosjes së Tenderit dhe është dashur të eliminohet nga procedura e prokurimit, e jo të vlerësohet si operator ekonomik i përgjegjshëm.

PRETENDIMI NR. 6

Ky pretendim lidhet me arsyetimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë, me arsyetimin se oferta jonë tejkalon vlerën e parashikuar për LOT-in përkatës.

Ky arsyetim nuk qëndron. Oferta jonë është brenda vlerës së përgjithshme të projektit. Problemi qëndron në faktin se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë një ndarje të drejtë dhe proporcionale të buxhetit sipas LOT-eve (Pjesëve) të kontratës. Konkretisht, për LOT 1 është paraparë i njëjti buxhet si për LOT 2, ndonëse shërbimet e kërkuara në këto dy LOT-e nuk janë të njëjta as për nga përmbajtja, as për nga vëllimi dhe kompleksiteti.

Nëse analizohet specifikimi i shërbimeve të kërkuara për secilin LOT, rezulton qartë se ato dallojnë në mënyrë të konsiderueshme. Për rrjedhojë, ndarja e një buxheti të njëjtë për të dy LOT-et nuk pasqyron nevojat reale të prokurimit dhe cenon parimin e proporcionalitetit në planifikimin e vlerës së kontratës. Duke qenë se ne kemi ofertuar për LOT 2, elimini i ofertës sonë vetëm mbi bazën se tejkalon vlerën e parashikuar për atë LOT nuk është i bazuar, pasi kjo vlerë rrjedh nga një ndarje joadekuate dhe jo proporcionale e buxhetit nga Autoriteti Kontraktues.

Nga analiza e specifikimeve teknike dhe pozicioneve të parapara në Parallogarinë e Çmimeve për LOT 1 dhe LOT 2, rezulton se ndarja e buxhetit në vlera të njëjta për të dy LOT-et nuk është bërë mbi bazën e nevojave reale të shërbimeve që do të ofrohen dhe as mbi bazën e kostove objektive të realizimit të kontratës.

Konkretisht:

- **LOT 2** përmban tri pozicione të veçanta të kostos:
 1. Grumbullimin, ngarkimin dhe shkarkimin e masës drusore (200 mł);
 2. Transportin e masës drusore dhe mjeteve të konfiskuara në një distancë totale prej **7,500 km**;
 3. Deponimin dhe ruajtjen e mjeteve motorike të konfiskuara për një periudhë prej **36 muajsh**, që paraqet një shërbim shtesë me kosto të konsiderueshme, pasi operatori ekonomik duhet të sigurojë hapësirë të përshtatshme, infrastrukturë, siguri fizike, mbikëqyrje dhe përgjegjësi për ruajtjen e mjeteve gjatë gjithë periudhës kontraktuale.
- **LOT 1**, në anën tjetër, përmban vetëm dy pozicione:
 1. Grumbullimin, ngarkimin dhe shkarkimin e masës drusore (450 mł);
 2. Transportin e masës drusore dhe mjeteve të konfiskuara në një distancë totale prej vetëm **5,500 km**.

Ndryshe nga LOT 2, **LOT 1 nuk përmban asnjë pozicion për deponimin dhe ruajtjen e mjeteve motorike**, që është një komponent me ndikim të drejtpërdrejtë në koston e kontratës. Për më tepër, edhe distanca e transportit në LOT 1 është **2,000 km më e vogël** se në LOT 2, duke reflektuar kosto më të ulëta operative për transport, konsum karburanti, amortizim të automjeteve dhe angazhim të personelit.

Përkundër këtyre dallimeve të qarta në përmbajtjen dhe vëllimin e shërbimeve, Autoriteti Kontraktues kishte paraparë **të njëjtën vlerë të buxhetit për të dy LOT-et**, dhe arsyetimi për eliminimin e tyre nga procedura për shkak se kemi tejkaluar vlerën e parashikuar për LOT nuk qëndron.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit nuk ka trajtuar fare çështjen e mjeteve motorike të konfiskuara që ndodhen aktualisht në ruajtje sipas kontratës paraprake. Në specifikimet teknike të procedurës së re nuk është përcaktuar statusi juridik dhe operacional i këtyre mjeteve, përkatësisht nuk është sqaruar nëse ato do të mbeten në përgjegjësi të kontraktorit aktual, do t'i transferohen operatorit ekonomik që do të shpallet fitues në procedurën e re, apo do të trajtohen në ndonjë mënyrë tjetër.

Sipas të dhënave, bëhet fjalë për mbi 40 mjete motorike të konfiskuara, për të cilat Dosja e Tenderit nuk përmban asnjë dispozitë apo specifikim teknik lidhur me mënyrën e trajtimit të tyre gjatë zbatimit të kontratës së re. Mungesa e këtij informacioni krijon paqartësi të konsiderueshme për operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave, pasi ndikon drejtpërdrejt në vlerësimin e kostove, përgjegjësi kontraktuale dhe rreziqeve që lidhen me ofrimin e shërbimit.

Për rrjedhojë, mungesa e këtij informacioni përbën një mangësi të Dosjes së Tenderit, pasi nuk u mundëson operatorëve ekonomikë të përgatisin oferta të sakta, të krahasueshme dhe të bazuara në të gjitha elementet që ndikojnë në ekzekutimin e kontratës.

Pra AK në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, e ka vlerësuar procedurën e prokurimit dhe ka bërë shkelje të dispozitave të cekura duke rekomanduar për kontratë një OE I cili nuk ka plotësuar kërkesat e FDT-së e po ashtu një OE tjetër e ka vlerësuar sit ë përgjegjshëm, ndërsa I njëjti nuk ka plotësuar asnjë nga kërkesat e FDT-së.

Kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ankesën tonë, të detyrojë AK që lëndën ta kthejë në RIVLERËSIM dhe pas rivlerësimit të ofertave në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, të na shpallë në fitues si operatori ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e pretenduar ka ndikuar drejtpërdrejt në shkaktimin e dëmeve materiale për kompaninë tonë, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe duke krijuar elemente të diskriminimit gjatë zhvillimit të kësaj procedure. Si rrjedhojë, jemi detyruar të përballojmë kosto shtesë, përfshirë shpenzimet administrative dhe financiare që lidhen me përgatitjen, paraqitjen dhe ndjekjen e procedurës ankimore. Këto shpenzime përbëjnë një barrë të panevojshme për operatorin ekonomik dhe ndikojnë negativisht në pozitën tonë konkurruese në treg.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*